

Riintegrimi i viktimave të dhunës me
bazë gjinore

**Mundësitë për të zhvilluar
plane të suksesshme
riintegrimi të viktimave të
dhunës me bazë gjinore në
bashkitë Kukës, Dibër, Korçë
dhe Berat**

Të Ndryshëm & Të Barabartë



This project is funded
by the European Union



Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E) 2022

Eksperte: Valbona Lenja

Studimi mbi “Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat” është përgatitur nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” në kuadër të projektit “Ofrimi i programeve të riintegrimit ekonomik për të paktën 80 gra në bashkitë e Kukësit, Dibrës, Korçës dhe Beratit, përfshirë edhe gratë e grupeve vulnerabël”, me mbështetjen e UN Women në kuadër të programit “Fund dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi Faza II”, financuar nga Bashkimi Europian.

Tabela e Përmbajtja

- I. Metodologjia e Studimit**
- II. Gjetjet Kryesore**
- III. Rekomandime të Përgjithshme**
- IV. Gjetjet dhe Rekomandimet për Bashkinë e Beratit**
- V. Gjetjet dhe rekomandimet për Bashkinë e Korçës**
- VI. Gjetjet dhe Rekomandimet për Bashkinë e Kukësit**
- VII. Gjetjet dhe Rekomandimet për Bashkinë e Dibrës**

- VIII. Anekse**
 - 1. Struktura e intervistës për shërbim ofrues**
 - 2. Struktura e Grupit të Fokusuar**
 - 3. Model Plani**
 - 4. Fjalorth**
 - 5. Referenca**

Hyrje

Qëllimi kryesor i studimit ishte identifikimi i mundësive për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të suksesshme të riintegritit të grave viktime të dhunës me bazë gjinore në bashkitë e përzgjedhura.

Objektivat specifike përfshinin: 1. mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi rezultatet e iniciativave të ndryshme kolektive dhe individuale për përmirësimin e situatës sociale dhe ekonomike të grave viktime të dhunës me bazë gjinore; 2. mbledhjen e rekomandimeve për zgjidhje më efektive.

Studimi është informuar nga gra në faza të ndryshme të ri-integritit dhe pavarësisë ekonomike, koordinatorë në bashki, punonjës të zyrave të punësimit, individë që bëjnë biznes në zonat e synuara, individë nga organizata ose institucione shtetërore që kanë qenë të përfshirë në mbështetjen e grave viktime të dhunës me bazë gjinore.

Lista e Shkurtimeve

AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
BSPSh	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DhT	Dhoma e Tregtisë
GF	Grup i Fokusuar
IShPShSh	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore
KKBGJ	Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore
MD	Ministria e Drejtësisë
NJPF	Ndihma Juridike Parësore Falas
NJDF	Ndihma Juridike Dytësore Falas
OShC	Organizata të Shoqërisë Civile
NjVKSh	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
QFP	Qendra e Formimit Profesional
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PF	Pikë Fokale
PMF	Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve
UM	Urdhri i Mbrojtjes
VDhBGJ	Viktima të Dhunës me Bazë Gjinore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. Metodologjia

Metodologjia përfshiu shqyrtimin e dokumenteve, intervista gjysmë të strukturuar dhe grupe të fokusuar (GF). Shqyrtimi i dokumenteve u fokusua në projektet dhe raportet studimore të agjencive të përfshira në asistencën dhe fuqizimin e grave, legjislacionin për ndihmën ndaj viktimave etj.. Intervistat gjysmë të strukturuar janë realizuar me stafin e institucioneve dhe përfaqësues të bizneseve. U organizuan gjithashtu GF me viktimat. Intervistat dhe GF-të u organizuan nga Pikat Fokale të projektit (PF) në secilën prej zonave¹.

II. Gjetjet Kryesore

Ndërsa situata social ekonomike e të mbijeturave të dhunës me bazë gjinore është e ndryshme në bashki të ndryshme, në të katërta bashkitë vlerësimi gjeti se:

- Në rastet e dhunës me bazë gjinore që përfshijnë nëna me fëmijë, ka praktikë të mirë të koordinimit të punës së koordinatorëve të dhunës me punonjësit e mbrojtjes së fëmijës—kjo praktikë megjithatë nuk është zyrtarisht e detajuar;
- Ka praktika të mira të pjesëmarrjes së individëve që kanë nevojë për ndihmë dhe po ndihmohen në proceset e vlerësimit dhe të vendimmarrjes;
- Ka zhvillime të rëndësishme në fushën e formimit profesional dhe të punësimit të cilat duhet të njihen dhe të shfrytëzohen. Të tilla janë p.sh., Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 535 lidhur me punën në komunitet i cili është një mundësi shumë e mirë për individët në ndihmë dhe organizatat që ndihmojnë. Ky instrument nuk njihet dhe nuk është përdorur. Është gjithashtu e nevojshme të njihet dhe të zbatohet VKM Nr. 17, datë 15.1.2020 “Për Procedurat, Kriteret dhe rregullat për Zbatimin e Programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”;
- Për zonën e Beratit, Kukësit dhe Peshkopisë të cilat nuk kanë qendër të formimit profesional ekziston vështirësia e fillimit të kurseve specifike të formimit profesional për shkak të pamundësisë së plotësimit të kriterëve: mungesës së ambjenteve, instruktorëve, numrit të kërkuar të të interesuarve etj.;
- Shoqëria civile / organizatat e shoqërisë civile që ndihmojnë grupe të veçanta në nevojë nuk janë përfshirë mjaftueshëm në forume dhe në entitete që marrin vendime lidhur me punësimin. Një mungesë e rëndësishme është mospjesëmarrja në Këshillin Konsultativ për Punësimin;²
- Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve, situata dhe nevojat e patrajuara të familjes së origjinës e tkurrin ndihmën e destinuar për të mbijetuarën e dhunës. Kjo sidomos kur në familjen e viktimës ka prindër, motra vëllezër që kanë dhe nuk mund të trajtojnë apo stabilizojnë probleme të vetat të shëndetit mendor apo fizik.

¹ Diana Kasa në Korçë, Mirela Buhuri në Berat, Lirie Gjana në Kukës, Sidorela Horeshka në Peshkopi

² Shih më poshtë tek anekset përbërjen e Këshillit

- Me gjithë përpjekjet, ndihma nuk ka arritur të shtrihet në familje dhe kjo e ka bërë të pamundur ndryshimin e gjendjes së viktimës dhe ka dekurajuar mbështetësit;
- Viktimat kanë në përgjithësi një pozicion pritës dhe hezitues në vlerësimin e situatës së tyre, në kërkimin dhe në marrjen e ndihmës. Kjo ka kufizuar shfrytëzimin e mundësive që jepen nga institucionet publike dhe organizatat;
- Një pjesë e mirë e viktimave të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) nuk e kanë ditur dhe nuk e kanë përdorur ndihmën ligjore falas. Ka raste në të cilat edhe pse aktualisht po ndihmohen me strehim, ndihma ushqimore etj., dhe kanë marrë informacion për shërbim falas, janë ende në procese me avokatë me pagesë;
- Ka një strukturë të qartë të nevojave dhe shprehjes së nevojave nga ana e viktimave. Shqetësimi kryesor i tyre për të cilin shprehen janë mirëqenia dhe siguria e fëmijëve dhe strehimi. Shqetësim tjetër që është i rëndësishëm por që hezitohet të artikulohet është pamundësia për të mbështetur prirjet dhe hobet e fëmijëve. Viktimat shprehen pak për nevojat e tyre- më shumë bazike dhe hezitojnë të shprehen për interesat dhe hobet e tyre;
- Një pjesë e viktimave, sidomos në fazat e para të ndihmës, nuk kanë informacion të detajuar mbi të drejtat, kohën e ndihmës, elementët, kriteret, etj., dhe kjo e rrit pasigurinë e tyre;
- Marrëdhënia e ndihmës është e dokumentuar në dosjet e ofruesve të shërbimeve – vetë viktimat nuk kanë përgjithësisht dokumente që vërtetojnë apo mund t’u referohen për marrëdhënien e ndihmës;
- Informacioni zyrtar mbi vendet e punës është i pakët dhe roli i institucioneve zyrtare të punësimit është rrjedhimisht i ulët. Ka raste që informacioni mbi vendet e punës nuk informohet e si pasojë nuk shpallet në faqen zyrtare të zyrave të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Kjo kufizon mundësitë që zyrat e AKPA-s apo institucionet e tjera të ndihmës të mbështesin punësimin e viktimave;
- Largësia nga vendi i punës rëndon dhe amplifikon problemet e tjera sidomos problemin e të ardhurave të pakta, dhe problemin e kujdesit për fëmijët.

III. Rekomandime të Përgjithshme

Rekomandimet e dhëna në të katër zonat konvergojnë në:

Shfrytëzimin e mundësive që japin ndryshimet ligjore lidhur me punësimin që përfshin:

- Vlerësimin sa më shpejt të rasteve dhe mundësive të mbështetjes së riintegritimit që jep VKM Nr. 535 lidhur me punën në komunitet;
- Organizimin e takimeve për njohjen nga bizneset dhe vetë viktimat të mundësive të VKM Nr. 17, datë 15.1.2020 “Për Procedurat, Kriteret dhe rregullat për Zbatimin e Programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”;
- Identifikimin dhe analizimin e rasteve të punësimit të kryera nga institucionet publike apo private pa shpallur në faqen/ faqet zyrtare të AKPA-s;
- Pjesëmarrjen e shoqërisë civile / organizatave të shoqërisë civile në Këshillin Konsultativ për Punësimin³;
- Mbështetjen e aktiviteteve që sigurojnë njohjen e mundësive të inspektoriatit të punës, bizneseve, institucioneve të punësimit dhe formimit profesional – sidomos takimeve shumëpalëshe: biznes, zyra e punës, sektori i barazisë gjinore – bordi i viktimave⁴;

Ndryshime në qasjen e shërbimeve

- Konsolidimin dhe aplikimin e konceptit të menaxhimit të “rastit familje” që përfshin familjen e origjinës, sidomos kur në familjen e viktimës ka situata të cilat e vështirësojnë mbështetjen e viktimës: prindër, motra, vëllezër që nuk mund të trajtojnë apo stabilizojnë probleme të shëndetit mendor apo fizik;
- Inkurajimin dhe mbështetjen e pjesëmarrjes aktive të vetë viktimave në proceset e ndihmës dhe dhënien e një pozicioni të ri më në kontroll të vlerësimit të situatës dhe ndihmës;
- Mbështetjen e aksesit të drejtpërdrejtë dhe sa më të shpejtë të viktimave tek informacioni i saktë mbi ndihmën ligjore falas në mënyrë që të mënjanohej shpenzimet dhe stresi i panevojshëm. Veprime të tilla duhet të përfshijnë: përditësimin e shërbimeve sidomos atyre të cilat ofrohen mbi baza projekti; shpalljen e kontakteve të ndihmës ligjore në vende të dukshme; grumbullimin dhe analizimin e informacionit për ndihmën e referuar dhe të marrë; bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile që japin ndihmë ligjore;
- Identifikimin e burimeve të ndihmës psikologjike dhe orientimin dhe mbështetjen për të marrë shërbimin e vlerësimit psikologjik dhe ndihmës psikologjike falas;
- Ndërmarrjen e veprimeve që marrin në konsideratë dhe mbështesin jo vetëm nevojat por edhe interesat dhe hobet e viktimave dhe të fëmijëve të tyre. Të tilla mund të jenë përfshirja në paketën riintegruese të: mbështetjes financiare për kurset e talenteve të fëmijëve (gjuhë të huaja; balet, futboll, etj.);

³ Shih më poshtë tek anekset përbërjen e Këshillit

⁴ Shih më poshtë rekomandimin për krijimin e një bordi të vetë viktimave

- Ndhimën e drejtpërdrejtë në plotësimin e dokumentacionit për bonuset e qerasë/ strehimin social;
- Përmirësimin e procesit të dhënies, cilësisë dhe sasisë së informacionit që i jepet viktimës që garanton informimin dhe sqarimin e vazhdueshëm lidhur me të drejtat, kohën e ndihmës, elementët, kriteret etj;
- Formalizimin e marrëdhënies së ndihmës nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve me përfituesit si palë të barabarta;
- Në procesin e vlerësimit të nevojave dhe të planifikimit të ndihmës, por edhe në matjen e performancës së vetë viktimës në procesin e ndihmës duhet të merren në konsideratë minimalisht elementë si: largësia e vendit të punës nga banesa e fëmijëve, gjendja shëndetësore dhe mendore e atyre që kujdesen për fëmijët ndërsa viktimat është në punë, sjellja e punëdhënësve – pagesat e sigurimeve, respektimi i kontratave;

Ndryshime në organizim, role etj.:

- Rritjen e rolit të ekipeve të njëjësive administrative në menaxhimin e rasteve dhe forcimi i rolit koordinues dhe mbështetës të sektorit të barazisë gjinore në bashki;
- Krijimin i një bordi këshillimor në nivel lokal/ vendor të viktimave të dhunës në familje, të ngjashëm me bordin këshillimor të viktimave të trafikimit që vepron në nivel qendror;

IV. Gjetjet dhe Rekomandimet për Bashkinë e Beratit

Informacion i përgjithshëm për vlerësimin

Informacioni për Bashkinë e Beratit u mbledh prej intervistave gjysmë të strukturuar me punonjësen e shërbimit social në bashki, një punonjëse të AKPA-s, dy organizata të shoqërisë civile dhe nga GF i zhvilluar me katër viktime të dhunës me bazë gjinore në faza të ndryshme të mbështetjes.

Gjetjet

Vlerësimi u informua për një mori situatash dhe çështjesh lidhur me dhënien e marrjen e ndihmës të cilat bëhen pengesë për ri-integrimin dhe pavarësinë ekonomike të viktimave.

Shqetësimet kryesore të informuara nga viktimat janë situata e fëmijëve dhe mbështetja për fëmijët, strehimi, mungesa e të ardhurave, diskriminimi në fushën e punësimit.⁵

Mbështetja psikologjike dhe sociale për viktimat dobësohet nga mungesa dhe mbingarkesa e stafit të shërbimit social në bashki. Në momentin e studimit, ishte vetëm një punonjëse që kryente rolin e koordinatores së dhunës dhe të punonjësës së mbrojtjes së fëmijëve. Diskriminimi dhe trajtimi degradues dhe fyes nga përfaqësues të institucioneve ishte një tjetër dëmtues i mirëqenies psikologjike dhe sociale dhe progresit në riintegrim. Gjatë takimit të Grupit të Fokusuar u ndanë përshkrime të trajtimit fyes nga punonjës meshkuj në polici dhe mësuesit në shkolla.

Individët viktime informuan se faktorë të fortë stresi ishin: siguria e fëmijëve – frika mos dhunuesi kërcënon, dhunon, manipulon fëmijët; dhënia e aksesit abuzuesit nga palë të treta, sidomos nga shkolla; pamundësia-mungesa e të ardhurave për të blerë ushqime dhe veshje për fëmijët; pamundësia për të përballuar blerjen e librave dhe mjeteve shkollore për fëmijët; ankthi për fëmijët të cilët jetojnë vetëm gjatë kohës që viktimat janë në punë; pamundësia për t'i vendosur fëmijët në kurse për ti ndihmuar me rezultatet në shkollë.

Për të gjitha viktimat që informuan studimin, gjendja emocionale e tyre dhe e fëmijëve lidhej shumë me pamundësinë e tyre për të mbështetur fëmijët në talentet e tyre edhe pse tarifat e kurseve për fëmijët ishin relativisht të ulëta. Sipas një prej individëve: *“kurset anglisht, futboll variojnë nga 1500- 2000 lekë në muaj”*

Strehimi konsiderohet një element i rëndësishëm i mirëqenies fizike dhe mendore, një tregues i pavarësisë dhe një element i rëndësishëm sigurie. Shqetësimet e shprehura nga pjesëmarrësit në FG lidhur me strehimin janë pamundësia për të paguar qeranë, paqartësia lidhur me sa do të zgjasë mbështetja për qeranë e shtëpisë, largësia nga vendi i punës.⁶

Vlerësimi nuk u informua për vështirësi në zgjidhjen e problemeve të shëndetit fizik. Problemet e shfaqura janë zgjidhur nga spitali. Megjithatë, vlerësimi gjeti se një nga rrethanat që

⁵ Informacion i mbledhur nga Grupi i Fokusuar

⁶ Një prej pjesëmarrëseve në Grupin e Fokusuar punonte në qytet por jetonte në fshat tek të afërmit;

vështirëson më shumë riintegrimin social dhe ekonomik të viktimave është pasja e të afërmeve me probleme të shëndetit mendor dhe fizik.

Punësimi më i përhapur u informua rrobaqepësia. Sipas një prej informuesve prej institucioneve: *“Punësimi i zakonshëm në Berat është fasoneria, prodhimi i çantave prej letre dhe këpucëve, dhe shumë pak turizëm”*. Edhe kërkimi në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe të Aftësive (AKPA-s për vende pune në rajonet e Beratit sugjeron se punësimet më të zakonshme të ofruara janë rrobaqepësi, bar, përpunim lëkure, prodhim artikuj letre.

Sipas viktimave shqetësim përbën mungesa e punësimit të përshtatshëm për rastet me kemp, punësimi edhe në rastet kur gratë kanë edukim – shkollë të lartë, oraret e tejzgjatura të punësimit në biznese.

Detyrimi i mbajtjes së kontaktit me zyrën e punës dhe konfirmimi i zyrës së punës për rregjistrimin në të është kusht për ndihmën ekonomike. Ky detyrim siguron kontakt të zyrës së AKPA me një pjesë të madhe të punëkërkuësve përfshirë edhe viktimat e dhunës me bazë gjinore. Është informacioni i pakët mbi vendet e punës ai që përbën shqetësim edhe për ofruesit e shërbimit edhe për viktimat vetë.

Ndryshimet në procedura kanë bërë që kontakti i AKPA-s me biznesin të reduktohet ndjeshëm. Duke qenë se biznesi nuk e ka më detyrim të sjellë fizikisht listën e punonjësve në zyrën e punës, *“zyra e punës të mos dijë më si më parë se çfarë pozicionesh ka”*,⁷ mënyra më e përdorshme për marrjen e informacionit është kontakti – takimi me bizneset. Megjithatë, shkak të burimeve të kufizuara për transport, vizitat e AKPA-s në biznese për të marrë këtë informacion janë të kufizuara.

Vlerësimi eksploroi lidhur me aktivitetet ekonomike që mund të zhvillohen nga viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe u informua që rritja e bimëve, gatimet, qëndistaria, shtizat, parukeria – janë aktivitete të cilat mund të ndërmerren në formë vetëpunësimi nga viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Për shkak se në Berat nuk ka një drejtori apo një qendër të mirëfilltë të formimit profesional⁸ kurset zhvillohen në shkollën profesionale. Atashimi i kurseve pranë shkollës profesionale kushtëzon kohën e kryerjes së tyre. Kurse të veçanta mund të hapen me aprovimin e Drejtorisë Rajonale të AKPA në Fier nëse plotësohen kriteret e vendosura në lidhje me ambjentin, instruktorin⁹, numrin minimal të personave të interesuar. Sipas informacionit të marrë, në kushtet e vështirësive të hapjes së kurseve para punësimit / të përgatitjes për punësim, për individët nga kategoria në fokus, do të funksiononte më mirë vënia në zbatim e Vendimit Nr. 17, datë

⁷ Aktualisht kërkohet që punonjësit e AKPA-s të vizitojnë biznese

⁸ Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Fier, Shkodër, (Tiranë, 1 dhe 4) Vlorë, Korçë dhe Qendra e Lëvizshme për Zonën Verilindore

15.1.2020 “Për Procedurat, Kriteret dhe rregullat për Zbatimin e Programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”

Shqetësim përbën edhe mbrojtja të drejtave të punës të viktimave të dhunës me bazë gjinore të punësuar. Gjatë vlerësimit u informua se edhe pse mund të ketë pakënaqësi lidhur me pagën, me orët e punës, pushimin pa të drejtë nga puna etj., përveçse hezitimit për të kërkuar të drejtat, ekziston edhe mungesa e informacionit mbi ku duhet të drejtohen të punësuarit dhe largësia prej autoriteteve të inspektimit. Berati nuk ka më një drejtori të rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (IShPShSh) por një Sektor Inspektimi që varet nga Drejtoria Rajonale e IShPShSh-së, Vlorë, Rajoni II.

Gjatë eksplorimit të nevojave dhe burimeve të mbështetjes financiare u informua mbështetja e viktimave nga të afërmit. U informua gjithashtu që në mënyrë që një familje e përbërë prej një gruaje kryefamiljare dhe dy fëmijë ka nevojë për afërsisht 60,000 lekë për të mbuluar shpenzimet. Diskutimi në FG përfshiu eksplorimin e avantazheve dhe disavantazheve të marrjes së ndihmës në formën e ndihmës materiale apo në para. Opinionet e viktimave ishin të ndryshme, një pjesë e konsideronin se ishte më mirë të merrnin ndihmë në formën e shërbimeve dhe materialeve, dhe një pjesë që konsideronin që ishte më mirë që ndihma të jepej në para të cilën ta administronin vetë.

Ndërsa informohen nevoja për financim, nuk informohen shërbime të veçanta financiare publike apo private për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Berat.

Shqetësimet e ndara prej viktimave lidhur me situatën ligjore përfshinë pamundësinë për të mbuluar shpenzimet për dokumente dhe pamundësinë për të paguar shpenzimet gjyqësore.

Për viktimat ishte e nevojshme që informacionin mbi avokatin falas ta kishte që në fillim, që në kontaktin e parë me policinë. Një prej pjesëmarrëseve u shpreh se nuk kishte njohuri për shërbimin ligjor falas dhe se vazhdonte të paguante për avokaten e marrë.

Studimi u interesua për nevojat dhe shërbimet e nxitjes së zhvillimit bujqësor për të mbledhur informacion dhe eksploruar mundësinë e punësimit dhe vetëpunësimit në bujqësi dhe blegtori.

Opinionet e viktimave të kontaktuara në Grupin e Fokusuar ishin të ndryshme dhe konsistonin në: fakti që viktimat kanë jetuar në fshat nuk do të thotë automatikisht që e njohin bujqësinë dhe blegtorinë – një grua që kur ka qenë vajzë ka pasur vëllezër ka qëndruar në shtëpi dhe nuk e njeh punën në bujqësi; pasja e terrenit dhe mjeteve për kopshtari do ta ndihmonte një grua të kompensonte rrogat e ulëta.

Diskutimi për qëndrimin e komunitetit kërkoi qëndrimin më gjatë në sjelljet negative të dy aktorëve kryesorë të policisë dhe të stafit në shkolla – mësuesit dhe psikologut.

⁹ Instruktorët për kurset vijnë nga Fieri

Paragjykimi i viktimës dhe fajësimi i saj ishte shqetësimi kryesor i viktimave. Në dy raste ky paragjykim dhe fajësim ndikonte drejtpërdrejt në mënyrën se si fëmijët i trajtonin ato/nënat e tyre. Njëra prej viktimave u shpreh se fëmija ishte aq i ndikuar sa refuzonte ta takonte atë/ të ëmën.

Studimi u informua se në shumë raste ka ose kthim të viktimës tek agresori ose varësi te ndihma të lidhura me të tjerë por edhe me vetë viktimën. Arsyet e përmendura janë: rastet nuk marrin ndihmën e duhur; vendimet e gjykatave çojnë drejt rikthimit; ndihma pa kushte krijon varësi; ndihma për një kohë të gjatë krijon varësi¹⁰; viktimat nuk janë mësuar të punojnë, janë në shumicën e kohës shtëpiake; nuk kanë trajtimin e duhur psikologjik për të filluar punë.

Sipas një prej informuesve, ka disa forma të zgjidhjes së shkaqeve të lidhura me qëndrimin e vetë viktimës të cilat në thelb kanë vlerësimin dhe trajtimin e individualizuar “rast pas rasti”.

Nga mënyrat e përmendura të përdorura janë: nxitja e shprehjes së hapur për nevojat; dhënia e kohës për të rimëkëmbur shëndetin fizik dhe emocional; ndihma në komunikim me të tjerë.

Sipas një prej informuesve *“në disa raste mbase viktimat nuk duhen lutur por detyruar të punojnë”*

Sipas informacionit të mbledhur, politikat për mbështetje të viktimave të dhunës me bazë gjinore kanë avancuar shumë, sidomos në fushën e punësimit. Megjithatë mungesat në burime dhe mungesa e të kuptuarit të njëjtë dhe e koordinimit mes institucioneve i bëjnë këto ndryshime të vështira për t’u aplikuar.

Rekomandimet për bashkinë Berat

- Mbështetja e Shërbimit Social të Bashkisë në Berat me staf dhe mjete pune;
- Organizimi i aktiviteteve për ndërgjegjësimin mbi detyrimet ligjore ndaj viktimave;
- Zhvillimi i programeve të kujdesit falas për fëmijët gjatë kohës që nënat janë në punë;
- Mbështetja që fëmijët të ndjekin kurse për rezultatet në shkollë;
- Mbështetja që fëmijët të ndjekin kurse për zhvillimin e talentet e tyre;
- Formalizimi i marrëdhënies ofrues shërbimi viktimë dhe dokumentimi – dhënia e kopjeve/ origjinaleve viktimave;
- Mbështetja financiare dhe materiale për familje raste kur familjarët kanë probleme të shëndetit fizik dhe mendor;
- Zhvillimi i kontakteve dhe takimeve të rregullta mes viktimave dhe zyrës së punës;
- Mbështetja e kurseve profesionale për të mundësuar dypunësimin e viktimave;
- Ndërgjegjësimi i institucioneve publike për shpalljen e vendeve të lira të punës në faqen e AKPA-s;
- Mbështetja e AKPA-s në aktivitetet e saj me bizneset;

¹⁰ Një prej informuesve shprehet se ka raste që kanë 20 vjet në ndihmë ekonomike

- Vlerësimi dhe individualizimi i dhënies së ndihmës: Materiale apo të holla që të kompensojnë të ardhurat e ulëta nga rroga dhe të arrijë në shumën 60,000 lekë për 3 persona/ muaj;
- Mbështetja e promovimit të ndihmës ligjore falas;
- Mbështetja me terapi për rivendosjen dhe shëndoshjen e marrëdhënieve me fëmijët pas divorcit;
- Vlerësimi i shkaqeve objektive dhe subjektive të papunësisë / mungesës së aktivitetit ekonomik para planifikimit të ndihmës;
- Vendosja e kufijve të ndihmës: afateve kohore të ndihmës, detyrave të punonjësve të institucioneve të ndihmës dhe vetë viktimës;

V. Gjetjet dhe Rekomandimet për Bashkinë e Korçës

Informacion i përgjithshëm

Informacioni në Bashkinë Korçë u mblodh prej intervistave gjysmë të strukturuar me punonjës të shërbimit social në bashki, Drejtoria Rajonale e Punësimit, Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik, një drejtuese e një qendre rezidenciale për vajza viktime ose fëmijë të neglizhuar, 3 viktime të dhunës me bazë gjinore në faza të ndryshme të mbështetjes, dhe një përfaqësues biznesi.

Vitin e kaluar, rreth 45 viktime të dhunës në famije kanë pasur nevojë për ndihmë riintegruese. Ato janë ndihmuar kryesisht nga organizata të cilat kanë në fokus fëmijët apo grupet e tjera vulnerabël.

Gjetjet

Struktura e mbrojtjes së fëmijëve në bashki përbëhet nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve e cila ka dy punonjës dhe administratorët socialë të 7 njësive administrative të cilët kryejnë rolin e punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe të koordinatorit për dhunën në familje.

Në Korçë ka pasur qysh herët shërbime të kujdesit për fëmijët në nevojë, përfshirë vajzat viktime të dhunës me bazë gjinore. Fondacioni Kenedi, një nga informuesit e këtij studimi, ka hapur në 2003 një qendër për fëmijët që lypin në rrugë. Qëllimi i qendrës është t'u japë fëmijëve që shpenzojnë ditën pa kujdes në rrugë, një ambient të sigurt për të luajtur dhe për t'u dashur. Fëmijët vizitohen në shtëpi nga stafi i Fondacionit, ndihmohen për shëndetin dhe arsimin. Në 2005, Fondacioni Kenedi hapi një shtëpi të sigurt për vajza që shfrytëzoheshin dhe nuk mund të jetonin në shtëpinë e tyre. Shtëpia e sigurt vazhdon të funksionojë për vajza 6 deri 18 vjeç. Një apartament i lidhur me shtëpinë e sigurt strehon vajzat pasi ato mbushin 18 vjeç.¹¹ 3 qendra ditore për fëmijët janë ngritur në pika të ndryshme të qytetit nëpërmjet bashkëpunimit të bashkisë me Misionin Emanuel dhe Dorkas – bashkia ka vënë në dispozicion ambientin dhe pagesën e ujit, energjisë, ndërsa organizatat stafin dhe shërbimin.

Gratë viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe ofruesit e shërbimeve informuan se shqetësimi për fëmijët dhe frika nga e ardhmja / frika se mbaron Urdhri i Mbrojtjes (UM) dhe fillon dhuna përsëri karakterizon gjendjen psikologjike të viktimave. Asnjë nga viktimat e kontaktuar nuk ka informuar se i është dhënë ndihmë e specializuar psikologjike. Ndër shqetësimet e shprehura për gjendjen e fëmijëve janë: shëndeti i fëmijëve, sidomos fëmijëve që kanë probleme me shëndetin; mbulimi i mjekimeve; kujdesi për fëmijët gjatë kohës që vetë nënat janë në punë; ndryshimi i rolit të fëmijëve – marrja e rolit të kujdestarit për fëmijët e tjerë; tërheqja nga ëndrrat dhe dëshirat e tyre; frika se fëmijët mund të bullizohen për shkak të situatës familjare; gjendja emocionale e fëmijëve; frika nga pasojat që dhuna ka patur dhe ka të fëmija. Ndihma e informuar

¹¹ <https://kenedifoundation.org/projects/#1632226722528-a927e2e6-2772>

që fëmijët e viktimave marrin aktualisht është për mjetet shkollore.¹² Për njërin nga viktimat e kontaktuara është e rëndësishme ndihma e dhënë për fëmijët: *"Për mua është ndihmë e madhe që nuk paguaj kopshtin e vajzës"*.

Studimi u informua se informacioni për strehimin social ishte i pakët dhe se ka individë nga institucione që nuk i njohin dhe nuk dinë t'i prezantojnë shërbimet e strehimit social. Shqetësim tjetër lidhur me strehimin ishte kohëzgjatja e mbështetjes për strehimin. Një prej viktimave u shpreh se mbështetja me bonusin e qerasë ishte e rëndësishme për të por edhe një burim frike, pasi mbështetja nuk mund dhe nuk do të vazhdojë gjithë jetën. Strehimi social ka qenë për 20 vite pjesë e Drejtorisë së Kujdesit Social në Bashki. Kohët e fundit, një drejtori më vete për strehimin social është krijuar dhe eksperiencia dhe ndjeshmëria që stafi ka ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore pritet që të japë një impakt pozitiv në shërbimin e strehimit. Ka aktualisht 23 raste të përfitimit nga strehimi social prej tre rajoneve të bashkisë dhe 6 prej këtyre rasteve janë raste të viktimave të dhunës me bazë gjinore.

Shërbimet mjekësore jepen nga institucionet publike. Fondacioni Kenedi informon se ka një klinikë që ndihmon me shërim plagësh, mjekime, fizioterapi. Studimi nuk është informuar për raste të viktimave të dhunës me bazë gjinore me probleme të shëndetit mendor. Korça ka një qendër komunitare të shëndetit mendor frekuentimi i të cilës ka ardhur në rritje. Studimi u informua se situata familjare rëndohet shumë dhe mbështetja e familjes së ngushtë dhënë viktimës kufizohet shumë sidomos në rastet kur në familjen e ngushtë dhe te prindërit e viktimës ka një person me probleme të shëndetit mendor.

Studimi u informua se megjithë përpjekjet prej të gjitha institucioneve, niveli i punësimit të viktimave të dhunës me bazë gjinore është i ulët. Nga 3 persona, viktimat e takuara, vetëm 1 ishte e punësuar. Sipas njërit prej informuesve të studimit, punësimi që kërkojnë gratë është zakonisht pastrimi.


Sipas informacionit të mbledhur, në Korçë është dominuese kërkesa për punësime lidhur me turizmin, çanta, veshje. Përpunimi i mishit është traditë dhe ka dy kompani të mëdha që japin mundësi punësimi në këtë aktivitet. Aktivitete të tjera ekonomike që konsiderohen të mundshme janë gatimet, prodhimi i pijeve, veshjeve, çantave, punimet me dorë, prodhimi i varëseve dhe unazave, shitja me pakicë- rroba, paketim, kujdesi në shtëpi, mobileri, mirëmbajtje banesash, punë sociale, shërbim për të moshuarit, aktivitete sociale, pastrim kimik. Sipas informacionit të mbledhur nga shumë burime, kujdesi për të moshuarit është një fushë që duhet të eksplorohej sepse ka eksperiencë - Fondacioni Kenedi ka punësuar gra në nevojë në shtëpinë e pleqve.

VKM-të për punësimin në punë publike apo vetëpunësim konsiderohen si mundësi shumë të mira për një zhvillim cilësor në fuqizimin ekonomik të viktimave. Studimi u informua se në bazë të VKM nr. 348, datë 29.4.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit" viktimat e dhunës me bazë gjinore të papuna mund të aplikojnë për fonde deri në 5 milionë lekë të vjetra. Megjithatë, studimi nuk gjeti që kjo mundësi të ishte përdorur.

¹² Dhënia e mjeteve shkollore u informua si ndihmë e rëndësishme për fëmijët nga vetë viktimat

Formimi profesional ofrohet nga Qendra e Formimit Profesional (QFP). Sipas informuesve ka një gamë të gjerë të kurseve të cilat mund të zhvillohen dhe nuk ka pengesa për nisjen e një kursi që nuk ka ekzistuar më parë. Studimi u informua se eksperiencë e mirë janë kurset “Start Smart“, të filluara me ndihmën e GIZ. Eksperiencë dhe kontribut në formim profesional ka gjithashtu edhe Fondacioni Kenedi. Për dy vjet me rradhë Fondacioni ka mbështetur kursin e rrobaqepësisë duke u dhënë edhe makina qepëse grave me probleme ekonomike dhe dhunë në familje. Ofrues të formimit profesional janë informuar edhe organizata të tjera, si në rastin e World Vision që ofron kurse për migrantët e rikthyer.

Për viktimat që informuan studimin është e rëndësishme që të mund të mësohet edhe në mënyrë autodidakte në shtëpi. Njëra prej tyre që po ndiqte kursin e rrobaqepësisë u shpreh: *“Një makinë më duhet të mësoj edhe në shtëpi, më dha një komshije po është e prishur. Më kanë thënë që do të më ndihmojnë.”*



Pamje nga Qendra e Formimit Profesional¹³

Në Bashkinnë Korçë nuk u informua për situata të konflikteve në punë të kohëve të fundit. Si mbrojtës të të drejtave të të punësuarve u informuan:

- në rastin e konflikteve kolektive- rrjeti i ndërmjetësve të zyrës së punës ¹⁴ e më tej zyra e pajtimit pranë zyrës së punës;
- në raste të konflikteve individuale- inspektoriati i punës. Të tjera struktura janë Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë KSSH, KSSH-ja në nivel rajoni, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSh).

¹³Marrë nga <https://www.botasot.info/shqiperia/1552148/korce-ne-kerkim-te-nje-zanati-te-rinjte-dynden-ne-qendrat-e-formimit-profesional/>

¹⁴ ILO informohet se po trejnon aktualisht ndërmjetësit

Studimi u informua edhe për nevojën që viktimat e dhunës me bazë gjinore të njohin jo vetëm strukturat e punësimit por edhe ato të mbështetjes në raste konfliktesh pasi janë punësuar.

Pjesë e studimit ishte edhe eksplorimi për situatën dhe shërbimet e mbrojtjes së tregtisë. U informua që ka vite që Dhoma e Tregtisë (DhT) nuk funksionon në Korçë.

Në Korçë studimi u informua për përdorim të shërbimeve financiare nga ana e viktimave. Një prej individëve të kontaktuar viktimë kishte marrë kredi nga një institucion privat kredidhënës për të blerë pajisjet elektroshtëpiake.

Ndihma juridike konsiderohet si një nga mungesat më të mëdha të ndihmës për viktimat. Kjo mungesë është plotësuar në baza vullnetare: koordinatorja e dhunës ka ndihmuar me aq njohuri sa ka pasur për kërkesë padinë. Njëra nga viktimat ka informuar se e ka paguar avokatin vetë. Studimi nuk u informua për hapjen së afërmi të ndonjë qendre të ndihmës juridike në Korçë.¹⁵

Përveçse institucioneve publike të bujqësisë, aktorë të tjerë të zhvillimit rural janë Fondacioni Kenedi dhe Dorcas. Fondacioni Kenedi informoi se ka zbatuar projekte që kanë ndihmuar fermerët me farëra dhe duke i mësuar. Sipas faqes së vet zyrtare, Dorcas, e njëjta organizatë që kontribuon në kujdesin për fëmijët, jep gjithashtu mundësi trajnimi për ndërmarrje biznesi dhe mundësi mësimi për të inkurajuar njerëzit të zhvillojnë një karrierë në sektorin e bujqësisë.¹⁶

Për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Korçë, shqetësimet lidhur me qëndrimin e komunitetit janë përhapja shpejt e informacionit për shkak se qyteti është i vogël dhe njerëzit njihen dhe qëndrimi negativ i njerëzve ndaj viktimave. Nevoja më e përmendur në lidhje me qëndrimin e familjes dhe komunitetit ndaj viktimës është nevoja për mbështetje nga familja dhe nevoja për besim në vendimet dhe veprimet e tyre: *“Gjëja e parë që kanë thënë për mua është: po kjo ku vete, si do jetojë vetëm, si do ia dalë?”*

Sipas vetë viktimave, pengesat për progres në riintegrim qëndrojnë tek mungesa e kujdesit për fëmijët gjatë kohës që ato, viktimat nëna janë në punë dhe hezitimi për të kërkuar ndihmë. Njëra prej tyre u shpreh: *“Më vjen zor të kërkoj”*.

Sipas individëve të tjerë që informuan studimin janë vetë viktimat që kanë një qëndrim pengues dhe kjo ka të bëjë me: mënyrën e rritjes; mungesën e modelit; mungesën lidhjeve dhe mbështetjes familjare; varësinë ekonomike që i mban të lidhura me bashkëshortët dhe i pengon për të ndjekur kurset dhe për t’u punësuar; pritja dhe varësia e krijuar te ndihma.

¹⁵ Në inaugurimin e qendrës së Ndihmës Juridike Parësore në Pogradec, në tetor të vitit 2020, ministria e drejtësisë informonte për tre qendra të administruara në bashkëpunim me UNDP në Durrës, Fier dhe Lezhë dhe planin për hapjen dhe administrimin edhe të 3 qendrave të reja në qytetin e Gjirokastrës, Shkodrës dhe Peshkopisë. Inagurimi i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Qyteti i Pogradecit

<https://drejtesia.gov.al/inagurimi-i-qendres-se-sherbimit-te-ndihmes-juridike-paresore-qyteti-i-pogradecit/>

¹⁶ Faqja e Dorcas <https://dorcias.org/countries/albania/>

Rekomandimet

Krijimi i kontekstit për reintegrim / qëndrimi i komunitetit

- Modelimi i sjelljes përfshirëse – organizatat duhet t'i përfshijnë viktimat në aktivitete dhe punësime në mënyrë të barabartë;
- Kapja/shfrytëzimi nga ana e organizatave e mundësive që jep shteti për viktimat – në përshtatje me pozicionin që kanë pasur në lidhje me tregun e punës – qoftë për punën në komunitet qoftë për vetëpunësimin;

Krijimi i kontekstit për riintegrim / qëndrimi i viktimave

- Nxitja e viktimave të flasin hapur dhe të kërkojnë ndihmë;
- Trajtimi i problemeve sociale përpara se të bëhen plane për futjen në punë;

Politikat e programet

- Formalizimi i marrëdhënieve mes ofruesve të shërbimit me viktimat;
- Fillimi i punësimit me modele të qasjeve të buta – Start Smart i GIZ ose Cikli i Punësimit;
- Aplikimi i Programit të punësimit me kohë të pjesshme nëpërmjet OJF-ve (VKM 535).¹⁷

¹⁷ Zyra e punës ka nxitur OJF-të në Korçë të aplikojnë për programin në 2022

VI. Gjetjet dhe Rekomandimet për Bashkinë e Kukësit

Informacion i përgjithshëm

Informacioni u mblodh prej intervistave gjysmë të strukturuar me punonjës të shërbimit social në bashki, punonjës të drejtorisë rajonale për punësim dhe aftësim, 7 viktime të dhunës me bazë gjinore në faza të ndryshme të mbështetjes dhe 2 individë të afërm të viktimave të dhunës me bazë gjinore.

Janë afërsisht 30 viktime të dhunës me bazë gjinore të cilat kanë nevojë për mbështetje për riintegrim¹⁸.

Gjetjet

Një nga karakteristikat më të përmendura të shërbimeve në Kukës është mungesa e shërbimeve nga organizatat e shoqërisë civile (OShC-të). Megjithatë, sipas planit lokal për rininë ”*Bashkia Kukës ka vazhduar bashkëpunimet me OShC-të. Ajo i ka ata partnerë në disa aktivitete dhe projekte të cilat janë në dobi të shoqërisë dhe komunitetit. Bashkia e Kukësit në njërin nga Drejtoritë e saj- e rinisë dhe koordinimit të projekteve i vë rëndësi të veçantë bashkëpunimit dhe ruajtjes së marrëdhënieve të mira të shoqërisë civile të cilat operojnë dhe janë në tregun e projekteve në Kukës. Ndër shërbimet që ofrohen në bashkëpunim me organizatat janë: fuqizimi socio-ekonomik i familjeve në vështirësi ekonomike, shërbimet alternative të kujdestarisë familjare, shërbimet për të rinjtë dhe fëmijët në nevojë dhe me aftësi ndryshe, buxhetimi me pjesëmarrje dhe përfshirja e qasjes gjinore në buxhetin territorial Qarku Kukës etj.*”¹⁹

Shqetësimet kryesore të informuara nga viktimat në Bashkinë Kukës janë:²⁰

- Banesa/ strehimi – sepse jetojnë me prindërit, vëllezërit apo me qera;
- Afatet e shtyrjes së urdhrit të mbrojtjes (UM-së) ;
- Problemet e shëndetit mendor të bashkëshortëve, pjesëtarëve të familjes;
- Veset e burrave– bixhozi, alkooli;
- Marrja e ndihmës e menjëhershme në momentin e dhunës;
- Ankthi i vazhdueshëm për fëmijët-efekti i dhunës, manipulimi i fëmijëve nga abuzuesi; kërcënimi që do marrë shtëpinë;
- Ndryshimi i abuzimit nga dhunë fizike në dhunë verbale e psikologjike pas marrjes së urdhrit të mbrojtjes;
- Papunësia e bashkëshortëve që shkakton stres e dhunë;
- Probleme të shëndetit fizik dhe mendor të shkaktuara nga dhuna;
- Trajtimi i fëmijëve nga të afërmit e viktimave;
- Shëndeti i fëmijëve;

¹⁸ Informacion nga koordinatoresha e dhunës në bashki

¹⁹ https://krk.al/ep-content/uploads/2020/10/Plani_lokal_i_veprimet_per_rinine_2020-2023_Kukes.pdf

²⁰ Informacion I mblodhur nga Focus Group

- Frika mos bashkëshorti mund të marrë fëmijët;
- Presioni i të afërmeve për t'ia dhënë fëmijët bashkëshortit të dhunshëm;
- Pamundësia për të shkuar jashtë shtetit sepse bashkëshorti nuk jep lejen që fëmijët të udhëtojnë;
- Pamundësia për të punuar për shkak të problemeve të shëndetit të fëmijëve;

Sipas informacionit të mbledhur, viktimat e dhunës me bazë gjinore zgjedhin ose të arsyetojnë me dhunuesin ose të kthehen tek burri dhunues për hir të fëmijëve. Ato shpesh kërkojnë shpjegime për sjelljen e dhunuesit dhe mbështetje psikologjike nga koordinatori i dhunës.

Viktimat e dhunës në familje janë në pjesën më të madhe me fëmijë dhe duhet të kujdesen për ta por edhe për persona të tjerë të familjes.

Shërbime të mbrojtjes së fëmijëve të ofruara në Bashkinë Kukës të informuara janë kryesisht shërbimet e Bashkisë. Bashkia ofron shërbime për fëmijë në nevojë për mbrojtje, për fëmijë jetimë, fëmijë në konflikt me ligjin, dhe fëmijë viktime dhune dhe trafikimi. Një organizatë, organizata “Për ju nëna dhe fëmijë” – asiston fëmijë, të rinj, gra e vajza në nevojë për ndihmë. Ndërsa shërbimet e Bashkisë janë vijuese, shërbimet e organizatës informohen në baza projekti.

Situata dhe shërbime të kujdesit ditor për fëmijët

Shërbime të kujdesit ditor për fëmijët informohen:

- Qendra Komunitare për PAK – ndihmon fëmijë me Aftësi Ndryshe me: shërbime terapeutike, programe rehabilituese dhe aftësim për jetën;
- Qendra Komunitare e financuar nga Terre des Hommes – ndihmon fëmijë dhe familje të rikthyera nga emigracioni, fëmijë viktime të mundshme trafikimi me: shërbime mbështetëse, aktivitete pas shkolle me fëmijët, mbështetje ekonomike nëpërmjet ndihmës me bazë materiale.

Studimi u informua për zhvillime pozitive në strehimin e menjëhershëm të sigurt për viktimat në kohë krize. Me mbështetjen e MShMS në bashki është ngritur së fundmi strehëza për gratë e dhunuara – ministria duhet të financojë punonjësit ndërsa bashkia ushqimin.

Viktimat jetojnë në banesa me qera dhe nuk kanë pronësi mbi banesat. Një nga problemet e hasura për strehimin është mungesa e banesave të lira që mundën të blihen apo të merren me qera. Sipas një prej informuesve, *“Njerëzit nuk i shesin apo i japin me qera shtëpitë sepse ndërtimi i rrugës e ka bërë të kollajshme ardhjen në Kukës dhe njerëzit i mbajnë shtëpitë”*

Mungesa e formalizimit të punësimit e bën të mundur aplikimin dhe dhënien e mbështetjes për qeranë. Mungesa e formalizimit përfshin: mungesën e rregjistrimit ose ”punën në të zezë”-personi rezulton zyrtarisht i papunë dhe nuk mund të aplikojë; mosdhënien zyrtarisht të rrugës së plotë – personi nuk plotësohen kriteret e masës së të ardhurave.

Si ofrues i shërbimit të strehimit informohet bashkia – në bashki ka një punonjës të dedikuar për çështjet e strehimit. Kategoritë të cilat ndihmohen janë familjet dhe individët në nevojë për strehim social. Sipas programeve të strehimit që aplikohen në bashki, mund të ndihmohen edhe viktimat e dhunës me bazë gjinore. Pritet që enti kombëtar i banesave të ofrojë banesa për shtresat në nevojë.²¹



Banesat e Ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave

Për sa i përket situatës dhe shërbimeve të shëndetit fizik, studimi u informua se përveç spitalit rajonal, shërbime shëndetësore jepen nga shoqata Alb-Aid që vepron në qark. Shoqata i shërben personave me probleme të shëndetit fizik, të dëmtuar nga minat. Shoqata ka një repart protezimi pranë spitalit të Kukësit që ofron prodhimin dhe vendosjen e protezave dhe ortezave.

²¹ <https://ekb.gov.al/banesa-me-kosto-te-ulet-ndertuar-nga-enti-kombetar-i-banesave-ne-kukes/>

Probleme të shëndetit mendor janë hasur edhe tek viktimat edhe dhunuesit. Në Kukës nuk ka një qendër komunitare të shëndetit mendor. Pranë Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor NjVKSh është i vendosur Shërbimi Psikosocial. Mundësitë që ka ky shërbim për viktimat është promovimi dhe orientimi në shërbimet rehabilituese.

Studimi eksploroj sfidat lidhur me aktivitetet ekonomike. Sfidat e informuara ishin: s'ka baxha në Kukës – nuk e ka marrë njeri përsipër të bëjë punishte për përpunimin e qumështit dhe të frutave; ka gra që merren me qilime dhe tezgjah por kanë vështirësi në shitje sepse nuk ka treg dhe kostot e prodhimit të qilimave i tejkaloknë mundësitë e blerjes në vend; është një fabrikë për prodhimin e çantave të letrës- janë të punësuara rreth 150 gra; ka prodhim blloqesh po nuk konsiderohet si punë për gratë; mbledhja e frutave të pyllit- është sezonale; nuk ka promovim të artizanatit (sillet shembulli i Pukës dhe i Hasit). Punësimi në turizëm, në bare e restorante, konsiderohet i pamundur për shkak se duhet marrë parasysh largësia dhe mungesa e transportit dhe kërkesat e biznesit për të punuar jashtë orarit (për dasma apo përtej orarit të kontraktuar).

Në analizën e situatës së punësimit të të rinjve në Kukës, në planin e veprimit të punësimit të të rinjve thuhet se “mungesa e bizneseve prodhuese, fasoneritë bëjnë që aktivitete e biznesit në Kukës të mos jenë më shumë a më pak se Bar–Kafe, pastičeri dhe furra buke. Këto biznese kanë të punësuar staf familjar e kjo nuk ndryshon shumë situatën e punësimit në Kukës por e lë në nivele të larta papunësinë. Vetëm në sezonin veror ka një rritje të vogël të punësimit në zonat malore ku janë ndërtuar restorante verore për turistë të huaj dhe vendas. Por kjo është periudhë e shkurtër e cila nuk ndikon në ngritjen e numrit të personave të punësuar. Marrëveshja mes ZVP dhe Bashkisë Kukës ekziston po duke qenë se në Kukës nuk ka mundësi punësimi ajo mbetet vetëm një shkresë zyrtare që nuk gjen dot zbatim”

Edhe informacioni i mbledhur nga intervistat sugjeron se në pjesën më të madhe, të ardhurat janë vetem nga ndihma ekonomike. Një pjesë shumë e vogël/ individë janë të punësuar në lokale si kuzhinierë, pastruese të afërm; në qëndistari private – punë në shtëpi.

Shqetësimet e shprehura lidhur me punësimin aktual përfshijnë:

- Për punësimin në lokale: oraret nuk përputhen me kujdesin për fëmijët;
- Për punësimin në shtëpi – qëndistari: pagesat shumë të ulëta në krahasim me fitimet e biznesit, pamundësia për të shitur/ për treg shitje prodhimi, xhelozia e burrave.

Probleme të tjera të informuara janë: mosshpallja e vendeve të punës nga institucionet nëpërmjet Drejtorisë / nga Drejtoria; mosangazhimi i institucionit të bashkisë për aplikimin e mundësive që jep legjislacioni²²

²² Vendimi i Këshillit të Ministrave 535 Mbi Procedurat , Kriteret dhe Rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet shihet si një mundësi shumë e mirë për kategoritë në fokus për shkak se fuashat e veprimit përfshijnë aktivitete për të cilat individët mund të formohen dhe punojnë : a) shërbimet e kujdesit për fëmijët; b) shërbime të kujdesit shëndetësor dhe social; c) shërbime të rehabilitimit të ish-perdoruesve të substancave narkotike; 9) punime dhe shërbime për komunitetin dhe mjedisin; d) shërbime këshillimi dhe informacioni;bdh) shërbime rinore; e) sport; e) art, turizem dhe kulture. <http://akpa.gov.al/ep-content/uploads/2020/08/VKM-Nr.535-date-08.07.2020.pdf>

5 persona kanë përfituar nga punësimi nëpërmjet programit të VKM 535.

Ekstrakt nga VKM 535 "Mbi Procedurat, Kriteret dhe Rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet"

Programi i punëve publike në komunitet zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, më poshtë AKPA, në bashkëpunim me organizatat e përcaktuara në pikën 5, të kreut III, të këtij vendimi, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e kësaj Agjencie, përfshirë aspektet financiare, ato të menaxhimit dhe të trajnimit. 2. Kohëzgjatja e mbështetjes së ofruar nga ky program është 12 muaj. 3. Punëkërkuessit e papunë, pjesëmarrës në këtë program, angazhohen 20 orë në javë gjatë 5 (pesë) ditëve të javës. Pjesën tjetër të ditës së punës punëkërkuessit e papunë pjesëmarrës mund të angazhohen në trajnim e shtesë. Trajnimi kryhet në qendrat publike të formimit profesional ose në ato private të licencuara. 4. Në dispozicion të punëkërkuessve të papunë, pjesëmarrës në këtë program, vihet një mbikëqyrës, sipas pikës 9, të kreut III, të këtij vendimi, i cili është përgjegjës për zhvillimin e planit individual të trajnimit (PIT) për çdo person të punësuar në projekt dhe për garantimin e zbatimit të këtij programi. 5. PIT-ja mund të përfshijë trajnime më të avancuara ose të specializuara të aftësive apo dhe mund të ofrohet si mbështetje për njohuritë bazë të shkrimit dhe leximit. Ndërsa një pjesë e trajnimit duhet të trajtojë një gamë të gjerë temash që lidhen me jetën dhe me punën për një orientim më të mirë në tregun e punës. 6. PIT-ja miratohet nga strukturat përkatëse të AKPA-së.

III. KRITERET E APLIKIMIT

1. Punëkërkuessit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuessit e papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 12 muaj në zyrën e punës, të moshës mbi 25 vjeç, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga specialisti përkatës i punësimit. Nevojat dhe profili i punëkërkuessit duhet të përshtaten me kërkesat për aftësi të vendit të punës që siguron programi për ta.
2. Punëkërkuessit, pjesëmarrës në këtë program, në rast largimi, mund të zëvendësohen vetëm gjatë tremujorit të parë të programit.
3. Një punëkërkuess mund të marrë pjesë vetëm një herë në këtë program, brenda një periudhe pesëvjeçare.
4. Punëdhënësit, të regjistruar në zyrën e punës, me të drejtë përfitimi në këtë program, janë: 2 a) organizata jofitimprurëse; b) organizata të shoqërisë civile; c) biznese sociale/sipërmarrje sociale/ndërmarrje sociale; ç) institucione publike.
5. Punëdhënësit duhet të jenë të specializuar në fushat e përcaktuara në pikën 3, të kreut I, të këtij vendimi, të cilët zbatojnë projekte me interes publik, në nivel vendor dhe në favor të komunitetit, të cilët kanë kapacitetet dhe eksperiencën e duhur për zbatimin e këtyre

projekteve.

IV. MBËSHTETJA E PËRFITUESVE

1, Punëdhënësi përfitues, sipas pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi, përfiton një grant për të financuar shpenzimet.

2. Për punëkërkesit e papunë, pjesëmarrës në program, financimet janë, si më poshtë vijon:

a) Financim i pages në shumën 50% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. b) Kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. c) Kupon për trajnim të punëkërkesve të papunë, pjesëmarrës në program, deri në 20.000 (njëzet mijë) lekë, në rastet kur trajnimet e miratuara nuk ofrohen nga ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional.

3. Për përfituesit jetimë që përfitojnë nga ky status edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, sipas legjislacionit në fuqi, prindër të vetëm me femijë nën 6 vjeç, prindërit e femijëve me aftësi të kufizuara, viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, përfitues të ndihmës ekonomike, romë dhe egjiptianë mbulohen edhe shpenzime të tjera, si më poshtë vijon: i. Bonus për shpenzimet e transportit mbulohen për të gjitha kategoritë e mësipërme, të cilët e kanë vendbanimin mbi 2 km nga vendi i punës, në vlerën prej 1600 (një mijë e gjashtëqind) lekësh në muaj; ii. Për prindërit e vetëm me femijë nën gjashtë vjeç jepet bonus në vlerën prej 3000 (tre mijë) lekësh në muaj, për ndjekjen e kopshteve dhe të çerdheve për çdo femijë në ngarkim; iii. Financim deri në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë për një person, por jo më shumë se 200,000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona, për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara.

Extrakt nga VKM 348 “Për Procedurat, Kriteret dhe Rregullat për zbatimin e Programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit “

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton kriteret, procedurat dhe rregullat për zbatimin e programit të vetëpunësimit, i cili ka si qëllim nxitjen e vetëpunësimit nëpërmjet krijimit të sipërmarrjeve të reja të punëkërkesve të papunë të interesuar.

2. Programi i vetëpunësimit është program njëvjeçar për mbështetjen e sipërmarrjeve të reja, nëpërmjet të cilit ofrohet trajnim për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit për aplikuesit dhe grant për përfituesit.

3. Fondi i nxitjes së punësimit për programin sipas pikës 1, të këtij kreu, mbulon shpenzimet

për: a) grantin për hapjen e biznesit të ri; b) vlerësimin e planeve të biznesit.

4. Ky program zbatohet bazuar në një proces të drejtë dhe konkurrues aplikimi.

5. Ky program zbatohet dhe administrohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA). 6. AKPA-ja, sipas nevojës, mund të kontraktojë subjekte të tjera publike, private apo organizata të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave është e lidhur me fushën e punësimit, për të bërë të mundur zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit, sipas legjislacionit në fuqi.

KRITERET E APLIKIMIT, PËRFITUESIT DHE MBËSHTETJA

1. Për të aplikuar në këtë program, aplikuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: a) Është punëkërkuar i papunë i regjistruar në strukturën vendore të punësimit; b) Ka një ide biznesi, e cila nuk është në kundërshtim me kriteret e konkurrueshmërisë, të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Punës dhe që deklarohet në bazë të një formulari të posaçëm, i cili përmban: i. përshkrimin e idesë së biznesit; ii. relevancën (rëndësinë); iii. burimet e nevojshme për realizimin e biznesit; iv. vlerësimin e gjendjes së mjediseve ku do të zhvillohet biznesi.

2. Punëkërkuari, i cili aplikon në këtë program, duhet të marrë pjesë personalisht në të gjitha hallkat e procesit.

3. Një punëkërkuar mund të përfitojë vetëm një herë nga ky program.

4. Shpenzimet për vlerësimin e planit të biznesit të të gjithë pjesëmarrësve, në vlerën jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë për çdo plan biznesi, sipas çmimeve të tregut për këtë lloj ekspertize, mbulohen nga AKPA-ja, nga zëri i buxhetit “Programet e nxitjes së punësimit”.

5. Programi subvencionon për të gjithë të përzgjedhurit si përfitues grantin për ngritjen e biznesit deri në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë. 6. Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga granti i financuar janë: a) blerja e pasurive të patundshme; b) çdo shpenzim që nuk lidhet dhe nuk përfshihet në planin e biznesit të miratuar; c) shpenzimet e kryera përpara nënshkrimit të marrëveshjes së grantit; ç) pagat, shpërblimet, qiraja dhe shpenzimet e tjera administrative

<http://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/VKM-348-dt29042020.pdf>

Sipas informacionit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Kukës ndihmon individë të interesuar për t'u përfshirë në programet e formimit profesional. Për personat e interesuar përfshirë personat e papunë mund të hapet çdo lloj kursi - nëse ka kërkesa dhe nëse gjendet instruktori në vend dhe ambjenti -Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Kukës i bën një kërkesë Agjencisë Kombëtare. Një komision vlerësimi vlerëson kushtet e një ambjenti privat që sugjerohet të përdoret si ambjent për kurset. Në momentin e studimit ka një kurs për kuzhinë dhe një kurs rrobaqepësie.

Informacioni i mbledhur sugjeron se kërkesë e qëndrueshme për gratë konsiderohet formimi për kuzhinë dhe parukeri. Rrobaqepësia konsiderohet si e ezauruar si kërkesë nga personat e papunë,

por mund të përdoret si një aftësi që mund të ndihmojë viktimat e dhunës të kenë një punësim/aktivitet ekonomik i dytë.

Të mësuarit e preferuar nga pjesëmarrësit në GF ishin parukeria, rrobaqepësia²³, qëndistaria, piktura.

Përveçse një sektori inspektimi të Inspektoriatit të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në Kukës²⁴ nuk informohen entitete të tjera publike apo private të mbrojtjes së të drejtave të të punësuarve. Nuk informohen shërbime financiare që mund të ndihmojnë viktimat e dhunës me bazë gjinore. Informohet se më parë UNICEF ka dhënë fonde për individë viktimat për hapje të bizneseve, Parukeri, Parfumeri, Qëndistari dhe Rrobaqepësi.

Studimi mblodhi të dhëna mbi ndihmën ligjore. Në përgjithësi viktimat janë të martuara, disa prej tyre për shkak të dhunës kanë hapur proces divorci. Sipas faqes së Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci (HRDC) të organizatës, shërbimet ligjore të saj përfshijnë: Ofrimin e shërbimeve juridike (ofrimi i këshillave ligjore dhe përfaqësimi në gjykatë, shërbimet parajuridike (ndërrhyrje për zgjidhjen e çështjeve administrative), shërbimet e klinikave (trajnimi i individëve për ndjekjen e çështjeve të tyre në institucionet administrative dhe gjyqësore)²⁵. Informacioni i marrë sugjeron se organizata HRDC ka filluar të funksionojë në bazë projekti në Kukës. Kanë një juriste dhe një psikologe. Projekti ende nuk është bërë publik dhe i aksesueshëm. Aktualisht një avokate private ka ndihmuar në mënyrë vullnetare koordinatoren e dhunës.

Departamenti i Bujqësisë në bashkinë e Kukësit u vjen në ndihmë individëve dhe grupeve të individëve të interesuar për zhvillimin e bujqësisë. Informohet se ky department ka mundësi për të subvencionuar dhe për të dhënë kredi viktimave për blerje të farërave, makinerive dhe pesticideve.

Studimi u interesua për mbështetjen financiare që marrin viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe u informua që Myftinia e Kukësit jep jep mbështetje financiare për familjet dhe individët.

Informacioni i marrë nga burime të ndryshme sugjeron se komuniteti është neglizhent ndaj fenomenit të dhunës. *“Qyteti është i vogël dhe çdo ngjarje merret vesh”*. Sipas një informuesi edhe vetë viktimat janë paragjyqese, mosbesuese, dhe jo bashkepunuese. Edhe në takimin me viktimat pati një diskutim në të cilin një prej pjesëmarrëseve i thotë një tjetre: *“pse u ktheve me burrin prapë?”*

Çështja kryesore e informuar lidhur me politikat dhe programet është mungesa e shoqërimit të politikave dhe programeve qoftë në nivel qendror, qoftë në nivel lokal me financimin e duhur dhe zbatimin e tyre në praktikë nga të gjitha institucionet e nivelit lokal.

²³ nga 7 gra që morën pjesë në konsultimin në grup, 3 janë shprehur se janë të interesuara për kurs rrobaqepësie

²⁴ <https://inspektoriatipunes.gov.al/adresat-e-ishpshsh-ne-qender-dhe-rajone/>

²⁵ <https://www.hrdc.al/index.php/en/services/our-services>

Rekomandimet

Krijimi i kontekstit për reintegrim / qëndrimi i komunitetit

- Adresimi i neglizhencës nëpërmjet aktiviteteve /takime sensibilizuese e informuese.

Krijimi i kontekstit për riintegrim / qëndrimi i viktimave

- Nxitja e qëndrimit bashkëpunues e besues i vetë viktimave nëpërmjet ngritjes e ofrimit të shërbimeve të nevojshme që u përgjigjen nevojave, komunikimit mes viktimave dhe ofruesve të shërbimit në takime individuale e në grupe;
- Duhet mbështetur – duhet konsultuar dhe inkurajuar që me punë dhe me mbështetje do dalin nga gjendja e vështirë.

Politikat e programet

- Shoqërimi i politikave dhe programeve qoftë në nivel qendror, qoftë në nivel lokal me financimin e duhur;
- Njohjen me modelet pozitive të zbatimit të programeve dhe politikave që mund të implementohen në kontekstin e zonës.
- Të zhvillohen aktivitete të cilat masin feabilitetin/realizueshmërinë e aktiviteteve ekonomike të cilat informohen si të mundshme: kujdesi për pleqtë, fëmijët e të cilëve kanë shkuar jashtë; organizimi i ditëve të panairit të punimeve e gatimeve etj..
- Financimi nga projektet e fuqizimit të viktimave i një biznesi të formimit profesional – Shfrytëzim i mundësive të VKM 535.

Lidhur me institucionet

- Bërja publike e projekteve të ndihmës të organizatave të ndryshme – dhënia e aksesit të drejtpërdrejtë për viktimat;

Lidhur me vlerësimin e nevojave

- Vlerësimet e nevojave të viktimave të dhunës me bazë gjinore që bëhen nga institucionet duhet të zhvillohen si vlerësime tërësore të nevojave duke përfshirë nevojat e gjithë familjes dhe asaj të origjinës;
- Kujdesi për fëmijët gjatë kohës që nëna është në punë;
- Marrja në konsideratë e nevojave të shëndetit mendor të anëtarëve të familjes- informimi për shëndetin mendor; ndihma me mjekime;
- Aksesimi në institucionet e shëndetit mendor;
- Ndhma me transportin;
- Ndhma me marrjen e mjekimeve;
- Aplikimi i vlerësimit të nevojave nga vetë viktimat- formular vetëvlerësimi i nevojave.

Lidhur me ndihmën/ paketën

- Paketa duhet të ketë shërbime afatgjata - shërbime të shtrira në kohë;
- Shërbimet e punësimit duhet të konsiderojnë që: duhet punësim më shumë sesa vetëpunësim— është më mirë të punësohen diku sesa të gjejnë tregun e shitjes; në punësim duhet konsideruar numri i fëmijëve dhe mosha e tyre; punësimi duhet të jetë i sigurt-viktima të mos punojë vetëm;

VII. Gjetjet dhe Rekomandimet për Bashkinë e Dibrës

Informacion i Përgjithshëm

Informacioni për bashkinë Dibër u mblodh prej intervistave gjysmë të strukturuar me punonjëset e shërbimit social në bashki, dhe 1 organizatë e shoqërisë civile.

Gjetjet

Viktimat e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Dibër janë gra të moshës 26 - 50 vjeç. Ato janë të martuara dhe jetojnë në familje të mëdha. Arsimi i tyre është i ulët dhe nuk kanë formim profesional. Të ardhurat janë zakonisht ndihma ekonomike.

Informohet se përveç bashkisë, shërbime për persona në nevojë ofrojnë edhe organizatat: Qendra Agritra-Vizion me target viktima të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore; organizata Terre des hommes me target viktima të trafikimit, organizata Plan & Go me target viktima të trafikimit dhe viktima të dhunës në familje, organizata Të Ndryshëm & Të Barabartë – viktima të trafikimit dhe viktima të dhunës me bazë gjinore. Me përjashtim të Argitrës, organizatat nuk e kanë selinë në Dibër. Kisha Alfa – Omega, edhe Xhamia informohet se ndihmojnë në mënyrë të konsiderueshme familjet në nevojë në bashki.

Specifikisht për fëmijët, përveç Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës ndihmojnë edhe organizatat Terre des hommes, dhe Plan & Go- të dyja me klasa mbështetëse. Bashkia Dibër operon një qendër ditore për fëmijët me aftësi ndryshe. Shqetësimi i informuar lidhur me qendrën ditore është transporti i fëmijëve.

Në Bashkinë Dibër është ngritur dhe funksionon strehëza e emergjencës 72 orëshe për viktimat e dhunës në familje. Sipas informacionit, strehimi emergjent dhe afatgjatë i viktimave të dhuës me bazë gjinore është një nga çështjet më problematike dhe më të vështira për t'u zgjidhur, Sipas një prej informuesve: *“Gratë dhe vajzat në rajonin e Dibrës nuk janë pjesë e asnjë pronësie”*. Informohet se dy organizata, Të Ndryshëm & Të Barabartë dhe Qendra Psiko- Sociale Vatra informohet se ndihmojnë me bonus qeraje për rastet e viktimave të trafikimit.

Vështirësitë e informuara lidhur me strehimin emergjent dhe me strehimin social informohen si të lidhura me mentalitetin në zone si edhe me procedura të vështira për përfitimin e bonusit të qerasë.

Aktivitetet ekonomike që konsiderohen me interes dhe të realizueshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore janë: rritja e bimëve medicinale, rritja e kafshëve dhe përpunimi i produkteve të tyre- për shkak të terrenit dhe kushteve klimaterike, mbledhja e frutave të pyllit, gatimet tradicionale, shitja me shumicë dhe pakicë, parukeri dhe estetikë.

Në Dibër nuk ka një qendër të formimit profesional.

Shërbime ligjore falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore/ viktimat e dhunës në familje informohen të jepen nga Qendra Argitra- Vizion dhe nga Zyra e Ndihmës Juridike Falas.

Studimi u informua për nevojë të ndryshimit të mentalitetit të komunitetit – paragjyqimeve nëpërmejt informimit dhe ndërgjegjësimit.

Ndryshimi në qëndrimin e komunitetit është konsideruar nga informuesit si i lidhur me shërbimet e ofruara – ofrimi i shërbimeve të plota dhe cilësore që siguron reintegrimin e suksesshëm afirmon të drejtën dhe rivendos reputacionin për viktimën.

Studimi u informua për një qëndrim pasiv dhe të tërhequr të viktimave për shkak të mentalitetit dhe mosbesimit tek vetja.

Rekomandimet

Krijimi i kontekstit për reintegrim / qëndrimi i komunitetit

- Të punohet me komunitetin për ndërgjegjësimin mbi të drejtat e viktimave të dhunës me bazë gjinore;
- Të mbështeten aktivitete ekonomike të cilat nuk e rëndojnë më shumë peshën e mentalitetit mbi viktimën;

Krijimi i kontekstit për riintegrim / qëndrimi i viktimave

- Të punohet për ndryshimin e mendësisë tek vetë viktimat për të inkurajuar tek to dëshirën dhe vetëbesimin për t'ja dalë.

Politikat e Programet

- Të lehtësohen procedurat për përfitimin e bonusit të qerasë;
- Të dedikohet më shumë buxhet për riintegrimin;
- Të mbështetet krijimi dhe konsolidimi i organizatave dhe grupimeve lokale që e njohin terrenin social dhe ekonomik;
- Të shtohet gama e shërbimeve që u ofrohen viktimave
- Të parashikohen fonde për punësim dhe përfshirje në aktivitete sociale

VIII. Anekset

Aneks 1. Struktura e Intervistës për shërbim ofruar

Hyrje

Ky studim kryhet për të identifikuar mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme sociale në nivel bashkie dhe plane individuale riintegrimi të grave viktime të dhunës me bazë gjinore.

Në këtë studim dhuna me bazë gjinore përdoret siç është përcaktuar nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave si ‘dhunë e drejtuar ndaj një gruaje sepse ajo është grua apo që ushtrohet më shumë ndaj grave. Përfshin akte që shkaktojnë dëm apo vuajtje fizike mendore apo seksuale, kërcënime për akte të tilla, shtrëngime dhe privime të tjera të lirive’

Në këtë studim reintegrimi i viktimeve të dhunës me bazë gjinore huazon kuptimin e procesit të riintegrit të viktimeve të trafikimit - të rikuperimit dhe përfshirjes ekonomike dhe sociale pas një përvoje trafikimi. Kjo përfshirje është e shumanshme dhe duhet të bëhet në fushat sociale, kulturore dhe ekonomike. Ajo përfshin vendosjen në një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm, qasje në një standard të arsyeshëm jetese, mirëqenie mendore dhe fizike, mundësi për zhvillim personal, social dhe ekonomik dhe qasje në mbështetje sociale dhe emocionale. Në shumë raste, ri / integrimi do të përfshijë kthimin në familjen e viktimeve dhe / ose komunitetin e origjinës. Megjithatë, mund të përfshijë gjithashtu integrimin në një komunitet të ri dhe madje edhe në një vend të ri, në varësi të nevojave dhe interesave të personit të trafikuar. Një aspekt qendror i ri / integrit të suksesshëm është ai i fuqizimit, mbështetja e viktimeve për të zhvilluar aftësitë drejt pavarësisë dhe vetë -mjaftueshmërisë dhe për t'u përfshirë në mënyrë aktive në shërimin dhe ri / integrimin e tyre.²⁶

Në këtë studim riintegrimi ekonomik ka kuptimin e të punuarit për të siguruar jetesën dhe për të patur perceptimin dhe ndjesinë e mirëqenies së sigurt.

Të Ndryshëm & Të barabartë ka marrë të gjitha masat që të gjitha opinionet e dhëna të mos çojnë në identifikimin e individit që i ka dhënë këto opinione. Ju jeni i/e lirë të kërkonit të identifikoheni nëse dëshironi.

Të dhëna demografike

I. Të dhëna demografike të vetë të intervistuarve

Gjinia	
Mosha	

²⁶ <https://nexusinstitute.net/ep-content/uploads/2015/03/reintegration-of-trafficked-persons-hoë-can-our-ëork-be-more-effective.pdf>

Fëmijë	
Arsimi	
Koha në kontakt me viktimat e dhunës me bazë gjinore	

II. Shërbimet në zonë

A mund të thoni cilët ofrues shërbimesh publikë apo privatë, zyrtarë apo jo zyrtarë operojnë në zonë/ zona specifike, cilëve kategori u ofrojnë ata shërbime, dhe cfarë mundësish kanë ata për riintegrimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore?

a) Shërbime të mbrojtjes së fëmijëve dhe foster care

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

b) Shërbime të strehimit

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

c) Shërbime të kujdesit ditor për fëmijët

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / çfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

d) Shërbime të shëndetit fizik

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / çfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

e) Shërbime të shëndetit mendor

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

e) Shërbime të formimit profesional

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / çfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

f) Shërbime të mbrojtjes së të drejtave të të punësuarve

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

g) Shërbime të mbrojtjes së tregtisë

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

h) Shërbime financiare

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

i) Shërbime Ligjore

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

j) Shërbime të nxitjes së zhvillimit bujqësor

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

k) Shërbime të nxitjes së zhvillimit industrial

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

l) Shërbime fetare

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

m) Shërbime të tjera

Ofruesi /emër	Zona specifike ku vepron	Grupi target	Mundësitë

Cilat janë rreziqet / cfarë mund t'i pengojë ata ti vënë në dispozicion të viktimave mundësitë që kanë?

Si mund të eliminohen rreziqet e përmendura?

III. Aktivitetet ekonomike²⁷

Në informacionin tuaj, cilat aktivitete ekonomike po u japin njerëzve të zonës të ardhura të mjaftueshme? A ka kërkesë për këto aktivitete? A ka burime natyrore te qendrueshme per kete aktivitet? A i konsideroni ju këto aktivitete si të mundshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe pse? Mund të përdorni listën e gatshme të aktiviteteve më poshtë:

Aktiviteti	Specifiko aktivitetin	Kush po i zhvillon	Burime Natyrore, cilat?	A ka kërkesë për këto aktivitete?	A janë të mundshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore?	Argumenti
Rritja e						

²⁷UN Department of Economic and Social Affairs Statistics Division International Standard Industrial Classification of All Economic Activities Revision 4, ST/ESA/STAT/SER.M/4/Rev.4

Aktiviteti	Specifiko aktivitetin	Kush po i zhvillon	Burime Natyrore, cilat?	A ka kërkesë për këto aktivitete?	A janë të mundshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore?	Argumenti
bimëve						
Rritja e kafshëve						
Gjuetia						
Peshkimi						
Rritja e peshkut						
Mbjellja , kujdesi për pyjet						
Prerja e druve						
Mbledhja e frutave të pyllit						
Shërbimet e lidhura me sektorët më lart						
Miniera qymyri dhe linjite						
Nxjerrja e naftës dhe gazit						
Shërbimet në miniera						
Përpunimi i mishit dhe peshkut						
Përpunimi i qumështit						
Gatime						
Prodhimi i						

Aktiviteti	Specifiko aktivitetin	Kush po i zhvillon	Burime Natyrore, cilat?	A ka kërkesë për këto aktivitete?	A janë të mundshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore?	Argumenti
pijeve						
Prodhimi i cigareve						
Prodhimi i fijeve tekstile						
Prodhimi i litareve						
Endja						
Prodhimi i gëzofëve						
Prodhimi i veshjeve						
Prodhimi i cantave dhe veshjeve te lekures						
Prodhimi i sendeve prej druri						
Prodhimi i letres						
Printimi shtypja						
Shërbime të lidhura me aktivitete më sipër						
Prodhimi i materialeve plastike						
Prodhimi i meterialeve të tjera jo						

Aktiviteti	Specifiko aktivitetin	Kush po i zhvillon	Burime Natyrore, cilat?	A ka kërkesë për këto aktivitete?	A janë të mundshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore?	Argumenti
plastike, tulla cimento etj,						
Prodhimi i metaleve , objekteve metalike						
Prodhimi i materialeve elektrike						
Prodhimi i pjesëve për makina transporti						
Prodhimi i mobilieve						
Prodhimi i varëseve , unazave						
Prodhimi i lodrave						
Kondicionimi i ajrir						
Uje kanalizime						
Menaxhimi i mbetjeve						
Ndërtim						
Riparime makinash						
Shitje me shumicë						
Shitje me pakicë						

Aktiviteti	Specifiko aktivitetin	Kush po i zhvillon	Burime Natyrore, cilat?	A ka kërkesë për këto aktivitete?	A janë të mundshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore?	Argumenti
Transport Njerëzish						
Magazininim						
Poste						
Publikim librash						
Prodhim muzikë						
Processim informacioni						
Bankë						
Sigurime						
Imobiliare						
Të tjera						
Sherbime shëndetësore spitale						
Design – interior exterior						
Turizëm – agjenci guida						
Investigim						
Mirëmbajtje banesash						
Paketim						
Administrim zyre biznesi						
Rend dhe siguri						
Sporte						
Edukim						
Punë sociale						

Aktiviteti	Specifiko aktivitetin	Kush po i zhvillon	Burime Natyrore, cilat?	A ka kërkesë për këto aktivitete?	A janë të mundshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore?	Argumenti
Shtëpi kujdesi për të moshuarit, të tjera						
Art						
Muzeume						
Bibliotekë						
Baste						
Aktivitete argëtuese						
Aktivitete ne organizata						
Riparime kompjuterash						
Riparime telefonash						
Riparime elektronike						
Riparime pajisjesh kopshti						
Riparime mobiljesh						
Riparime te materialeve te lekures						
Funeral						
Parukeri estetike						
Pastrim kimik						

IV. Të dhëna të përgjithshme për viktimat

Sa viktimat të dhunës me bazë gjinore kanë nevojë për riintegrim? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cfarë moshe kanë përgjithësisht viktimat e dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cili është përgjithësisht statusi martesor i viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cila është përgjithësisht etnia e viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cila është përgjithësisht përbërja familjare e viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cili është përgjithësisht arsimi i viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cili është përgjithësisht formimi profesional i viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cilat janë përgjithësisht të ardhurat e viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cili është përgjithësisht statusi i punësimit i viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cila është përgjithësisht pronësia mbi shtëpinë e viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cili është përgjithësisht aksesi në internet i viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

Cilat janë përgjithësisht interesat / hobet viktimave të dhunës me bazë gjinore? Si mendoni se ndikon kjo në riintegrim?

V. Krijimi i kontekstit për riintegrim

Cilat janë qëndrimet e komunitetit që duhen ndryshuar për të krijuar ambjentin pozitiv për riintegrimin e viktimave?

Si mund të ndryshohen qëndrimet e komunitetit?

Cilat janë qëndrimet e viktimave që duhen ndryshuar për të krijuar ambjentin pozitiv për riintegrimin e tyre?

Si mund të ndryshohen qëndrimet e viktimave?

A duhen bërë ndryshime në politika dhe programe për të siguruar riintegrimin e viktimave? Cfarë ndryshimesh duhen bërë?

Cilat janë dokumentat e programatikë apo të politikave që duhen ndryshuar dhe si?

A duhen bërë ndryshime në praktika për të krijuar ambjentin pozitiv për rintegrimin e viktimave? Cfarë ndryshimesh duhen bërë?

VI. Sugjerime për informant të tjerë

A mund t'i sugjeroni një individ tjetër që ta ndihmojë studimin/ të japë intervistë?

Shumë Faleminderit!

Aneks 2: Struktura e Grupit të Fokusuar

Vendi: Pranë apo në një vend të zgjedhur nga koordinatori

Numri maksimal i pjesëmarrësve: 9

Pyetjet:

Cilat janë shqetësimet tuaja kryesore?

Cila është ndihma e nevojshme dhe shërbimet që merren?

Kush është aktiviteti ekonomik i mundshëm dhe i përshtatshëm?

Kush janë qëndrimet që duhet të ndryshohen?

Cilat janë rekomandimet tuaja lidhur me ndihmën?

Aneks 3. Model i Planit të Riintegritit

PLANI I BASHKISË.....PËR RIINTEGRIMIN E VIKTIMAVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE²⁸

HYRJE

Ky Plan është hartuar me kontributin e Grupit të Punës të krijuar në kuadrin e projektit “Ofrimi i programeve të riintegritit ekonomik për të paktën 80 gra në bashkitë e Kukësit, Dibrës, Korçës dhe Beratit, përfshirë edhe gratë e grupeve vulnerabël”, me mbështetjen e UN Women në kuadër të programit “Fund dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi Faza II”, financuar nga Bashkimi European”.

Grupi i punës është përbërë nga (..... grupi i punës). Hartimi i Planit u parapri nga një vlerësim i zhvilluar nga eksperte Valbona Lenja, në periudhën.....Pjesëmarrja e të mbijetuarve në vlerësim siguroi informacion të dorës së parë mbi shqetësimet e të mbijetuarve në Bashkinë Shqetësimet përfshijnë: (shqetësimet sipas vlerësimit)

Qëllimi Kryesor i këtij Plani është adresimi i këtyre nevojave dhe shqetësimeve, është krijimi dhe funksionimi i një konteksti social dhe ekonomik dhe dhënia e ndihmës që lehtëson riintegritin e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe parandalon viktimizimin.

PARIMET E HARTIMIT TË PLANIT

Hartuesit e këtij Plani kanë ndjekur parimet e:

- *Koordinimit dhe Harmonizimit:* Aplikimit të një qasjeje që merr në konsideratë dhe harmonizon rolet, përgjegjësitë dhe burimet e sektorëve të ndryshëm, niveleve të ndryshme, të institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile, institucioneve fetare, ndërmarrjeve private etj.;
- *Pjesëmarrjes:* Personat e prekur nga dhuna me bazë gjinore marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit;
- *Barazisë gjinore në trajtimin e dhunës me bazë gjinore:* Marrja parasysh e pabarazive dhe dallimeve gjinore që nxisin dhe mundësojnë dhunën me bazë gjinore përfshirë nevojën që burrat të mbështeten në ndryshimet e nevojshme;
- *Të drejtat e Njeriut:* Aplikimi i një qasjeje të bazuar te të drejtat e njeriut, të përqëndruar te të mbijetuarit për ofrimin e shërbimeve te të gjithë, pavarësisht nga mundësitë financiare;

²⁸ Ky është një model i krijuar duke marrë në konsideratë gjetjet e vlerësimit. Grupet e punës mund të përdorin strukturë tjetër me të cilën mund të jenë më të familjarizuar

- *Zgjerimin e rrethit të ndërhyrjeve: dhënien e mbështetjes jo vetëm për individin viktimë e dhunës me bazë gjinore, por edhe për fëmijët e familjarët*

SHKURTIME

REFERENCA LIGJORE

Hartimi i këtij Plani u mbështet në parashikimet ligjore mbi mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore e në mënyrë të veçantë në:

Ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”;

Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;

Ligjin nr.9970 datë 28.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;

Ligjin nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës”;

Ligjin nr. 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;

Ligjin 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH”;

Ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”;

Ligjin 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në RSH”;

Ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

Ligjin 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;

Ligjin Nr, 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” ;

Ligjin 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

Ligjin 22/2018 “Për strehimin social”;

Ligjin 110/2018 “Për noterinë”;

Ligjin 111/2018 “Për kadastrën”;

Ligjin 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”;

Ligjin 57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”;

Ligjin 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”;

Vendimin e Kuvendit nr. 113/2017, datë 4 dhjetor 2017 “Për Ngritjen e Nënkomisionit “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas”;

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 789 datë 26.12.2018 “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 716, datë 1.12.2017 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale”

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 16, datë 12.1.2018 “Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale”

VKM Nr. 535, Procedurat kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 17, datë 15.1.2020 “Për Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”

Urdhëri i Kryeministrit Nr.32, datë 12.02.2018 “Për përcaktimin e koordinatorit kombëtar për barazinë gjinore”

Udhëzimin Nr. 816, datë 27.11.2018, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e standarteve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të Qendrave të menazhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”

Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm Nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrimit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”,

Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”

Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 9, datë 17.06.2020 “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 400 datë 3-06,2021” Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030 dhe të Planit të saj të Veprimit”

OBJEKTIVAT

- 1.1 Përgatitja për përgjigje të menjëhershme dhe të qëndrueshme ndaj nevojave të riintegritit të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore;
- 1.2 Dhënia e ndihmës së qenësishme në kohë dhe me cilësi individëve dhe familjeve;
- 1.3 Krijimi i më shumë mundësive ekonomike për gratë që janë të cënueshme ndaj abuzimit për shkak të varfërisë;
- 1.4 Ndërgjegjësimi për nevojën e ndryshimit të normave dhe sjelljeve shoqërore që ushqejnë dhe ruajnë dhunën;
- 1.5 Forcimi i llogaridhënies së aktorëve;

MATRICA E PLANIT

Objektivi 1.1 Përgatitja për përgjigje të menjëhershme dhe të qëndrueshme ndaj nevojave të riintegritit të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
Vlerësimi i numrit dhe nevojave të individëve dhe familjeve që duhet të ndihmojë Plani i Veprimit						
Përcaktimi i vlerës/ investimit monetar minimum të nevojshëm për të ndihmuar një individ në dhe me familjen						
Përcaktimi i vlerës/ investimit monetar minimum të nevojshëm për të zbatuar kërkesat ligjore nga secili institucion						

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
Përcaktimi i nevojave për prokurim të shërbimeve						
Përcaktimi i kriterëve të përzgjedhjes dhe monitorimit të ofruesve të shërbimeve për prokurimin e shërbimeve						
Përzgjedhja e ofruesve të shërbimit						
Lidhja e marrëveshjeve me ofruesit e shërbimeve						
Monitorimi në vazhdim shërbimit të ofruar						
Mbajtja funksionale e qendrës së emergjencës						
Mbajtja e kontakteve me ofrues shërbimesh në bashki të tjera						
Ngritja e kujdesit pas shkolle për fëmijët (kur nëna është në punë)						
Ngritja e kapacitetit të aktorëve						

Objektivi 1.2 Dhënia e ndihmës së qenësishme në kohë dhe me cilësi individëve dhe familjeve

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
Realizimi në kohë dhe me pjesëmarrje të takimeve të vlerësimit të nevojave, planifikimit të ndihmës						
Transporti në vend të sigurt (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në rast se është e nevojshme)						
Ushqimi Fjetja Higjena në Qendrën e Emergjencës						
Konsultim me psikologun (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në rast se është e nevojshme)						
Konsultim ligjor (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në rast se është e nevojshme)						
Mbështetje për problemet ligjore/ ndihmë juridike falas (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në						

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
rast se është e nevojshme)						
Transport në takime (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në rast se është e nevojshme)						
Ekzaminime, trajtim mjekësor (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në rast se është e nevojshme)						
Mbështetje për problemet psikologjike (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në rast se është e nevojshme)						
Aktivitete jashtëshkollore hobe, interesa për fëmijët						
Strehim i pavarur në apartamente private, strehim social, etj..						
Mbështetje për kurse profesionale						
Këshillim për punësim (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në rast se është e						

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
nevojshme)						
Mbështetje për transportin për punë						
Mbështetje për transport në punë, në shkollë (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në rast se është e nevojshme)						
Mbështetje për dokumentacion (i individit dhe fëmijëve dhe familjarëve në rast se është e nevojshme)						
Mbështetje për takime me individë të tjerë që po ndihmohen						
Mbështetje për ankesa						

Objektivi 1.3 Krijimi i më shumë mundësive ekonomike për gratë që janë të cënueshme ndaj abuzimit për shkak të varfërisë

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
Vlerësimi i thelluar i mundësive për zhvillim të aktiviteteve ekonomike në Bashki						
Subvencionimi						

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
i aktiviteteve private						

Objektivi 1.4 Ndërgjegjësimi për nevojën e ndryshimit të normave dhe sjelljeve shoqërore që ushqejnë dhe ruajnë dhunën

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
Organizimi i dy fushatave të ndërgjegjësimit të publikut						
Prodhimi i një broshure mbi efektet që ka dhuna me bazë gjinore tek fëmijët						

Objektivi 1.5 Forcimi i llogaridhënies së aktorëve

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
Hartimi i listës së treguesve të pjesëmarrjes dhe suksesit për secilin aktor						
Organizimi i takimeve të rregullta për Planin dhe mbarëvajtjen e bashkëpunimit						
Studimi / Mbledhja dhe analizimi në mënyrë të						

Veprimi	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Treguesit e realizimit	Dokumentimi
rregullt i procesverbaleve të takimeve raporteve periodike të institucioneve dhe shpërndarja e gjetjeve dhe rekomandimeve						

Aneks 4. Fjalorth

“**Dhunë me bazë gjinore ndaj grave**” do të thotë dhunë që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale²⁹

“**Fëmijë**” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.³⁰

“**Dhuna ndaj grave**” është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë ose mund të rezultojnë në dëmtim fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik ose vuajtjet e grave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike ose private³¹

“**Dhunë në familje**” do të thotë të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë familjare ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve të mëparshëm ose aktualë, pavarësisht nëse dhunuesi ndan ose nuk ndan të njëjtën banesë me viktimën³²

“**Gjini**” do të thotë rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat³³

“**Fuqizimi ekonomik**” Banka Botërore e përkufizon fuqizimin ekonomik të grave si “bërja e tregjeve funksionale për gratë dhe fuqizimi i grave për të konkurruar në tregje”³⁴

“**Dhuna në internet**” i referohet çdo akti dhune me bazë gjinore ndaj një gruaje që kryhet, ndihmohet ose rëndohet pjesërisht ose plotësisht nga përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), si telefonat celularë dhe telefonat inteligjentë, interneti, platformat e mediave sociale ose email, kundër një gruaje sepse ajo është një grua, ose ndikon grate në mënyrë disproporcionale³⁵

Viktima në qendër: Një qasje e përqendruar te viktima është fokusimi sistematik në nevojat dhe shqetësimet e një viktime për të siguruar ofrimin e dhembshur dhe të ndjeshëm të shërbimeve në një mënyrë jo-gjyquese. Ai synon të minimizojë traumatizimin e lidhur me proceset e drejtësisë penale duke ofruar mbështetje për avokatët e viktimave dhe ofruesit e shërbimeve, duke fuqizuar

²⁹ Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

³⁰ Ligj nr. 18/2017 Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

³¹ Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

³² Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

³³ Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

³⁴ Maria Elena Ruiz, Abril, “Politika Ekonomike të Duhura për Gratë në Shqipëri Policy Issues and options for Women’s Economic Empowerment” A Policy Issues Paper, UNWOMEN 2012

³⁵ Human Rights Council A/HRC/38/47 Report of the Special Rapporteur on violence

against women its causes and consequences on online violence against women and girls from a human rights perspective – Advance edited version 14 June 2018

të mbijetuarit si pjesëmarrës të angazhuar në proces dhe duke u ofruar të mbijetuarve një mundësi për rol në sjelljen para drejtësisë së shkelësve³⁶

Reintegrimi është një proces i mbështetjes profesionale multidimensionale dhe arritjes së shëndetit dhe mirëqenies së plotë të një individi pas eksperincave të dhunës me bazë gjinore. Etapat / fazat janë: 1. Asistenca fillestare. Ndërhyrja në situatë krize; 2: Asistenca afatmesme. Tranzicioni; 3. Asistenca afatgjatë dhe përfshirja sociale

“Dhuna ndaj grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë ose mund të rezultojnë në dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik ose vuajtje të grave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike ose private³⁷

³⁶ [https://www.ovcttac.gov/taskforceguide/eguide/1-understanding-human-trafficking/13- victim-centered-approach/](https://www.ovcttac.gov/taskforceguide/eguide/1-understanding-human-trafficking/13-victim-centered-approach/)
26 Adapted from ISGPS

³⁷ Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

Aneks 5. Referencat

Ligji nr 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 15/2019, “Per nxitjen e punësimit”,

VKM Nr. 17, datë 15.1.2020 “Për Procedurat, Kriteret dhe Rregullat për Zbatimin e Programeve të Nxitjes së Punësimit nëpërmjet Punësimit, Formimit në punë dhe Praktikave Profesionale “

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 29.4.2020 “Për Procedurat, Kriteret dhe Rregullat për zbatimin e Programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit “

Vendim i Këshillit të Ministrave 535, “Për Procedurat, Kriteret dhe Rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet”

Raporti i Monitorimit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019 – 2022³⁸

Ligji Nr. 22/18 “Për strehimin Social“

VKM Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore “

VKM Nr.1093, datë 08.02.2018 “Për miratimin e procedurave, kriterëve dhe përparësive në dhënien e bonusit të strehimit” i ndryshuar.

https://ëëë.adisa.gov.al/ëp-content/uploads/2021/01/AL112041_SHKP_Aplikim-p%c3%abr-programet-e-nxitjes-s%c3%ab-pun%c3%absimit-.pdf

Plani lokal i veprimit për rininë 2020-2023, Kukës, https://krk.al/wp-content/uploads/2020/10/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Kukes.pdf

Manuali i Procedurës së Funkzionimit të Qendrës për shërbime me bazë Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara. <https://kukesi.gov.al/ëp-content/uploads/2019/09/Manuali-i-Procedurave-Qendrat-Komunitare.pdf>

Partners Albania for Change and Development, 2019, Mapping and assessment of civil society organizations’ networks in Albania, https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2019/12/Mapping_and_assessment_of_civil_society_organizations_networks_in_Albania.pdf

³⁸ <https://akpa.gov.al/publikime-shkp/>